## Titulli i lëndës: Menaxhmenti strategjik

| **Informatat themelore për lëndën** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Menaxhment |
| **Titulli i lëndës:** | Menaxhmenti strategjik |
| **Niveli:** | Bachelor |
| **Statusi i lëndës:** | Obligative |
| **Viti i studimeve:** | Viti i tretë (Semestri VI) |
| **Numri i orëve në javë:** | 2+1 |
| **Kreditë ECTS:** | 4 ECTS |
| **Koha / Vendi:** | E martë (11:30-13:00) Salla 4 |
| **Mësimdhënësi:** | Albana Berisha Qehaja |
| **Të dhënat kontaktuese:** | albana.berisha@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Menaxhmenti strategjik |
| **Qëllimet e lëndës:** | Kjo lëndë synon të japë njohuri studentëve mbi analiza strategjike, formulimin e strategjisë, implementimin e strategjisë, kontrollin e strategjisë dhe konceptet bashkëkohore në menaxhimin strategjik. |
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët duhet të jenë në gjendje që:<br>• Të përshkruajnë procesin e menaxhmentit strategjik<br>• Të shkruajnë një vizion dhe mision të mirë<br>• Të njohin rëndësinë e analizës së jashtme dhe te brendshme të mjedisit<br>• Të dinë të sqarojë SWOT analizën dhe BCG matricën<br>• Të jenë në gjendje të shpjegojë pse implementimi i strategjisë është më i vështirë se formulimi<br>• Të dinë të përshkruajë kornizën e vlerësimit të strategjisë |
| **Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës** | Menaxhmenti strategjik është një disiplinë që synon të ofrojë njohuri teorike mbi procesin e menaxhimit strategjik por edhe të pajisë studentët me shkathtësi praktike për zbatimin e këtij procesi në organizata. |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Përgatitje për test intermediar | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | 2 | 15 | 30 |
| Puna në terren | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Testi, punimi seminarik | 2 | 2 | 4 |
| Detyrë shtëpie | | | |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | | | 45 |
| Përgatitja për provimin final | 4 | 1 | 4 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 6 | 1 | 6 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 2 | 6 | 12 |
| Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë... | | | |
| **Total** | | | |

| | |
|---|---|
| **Metodat e mësimdhënies:** | Mënyra e të mësuarit do të jetë përmes ligjëratave dhe ushtrimeve (me studime rasti dhe punime seminarike do të realizohen ushtrimet). Mësimi do të zhvillohet në grupe. Për çdo segment të një ligjërate përgatitet prezantimi edhe në sllajde ku u prezantohet studentëve rregullat, principet themelore të njësisë mësimore. Në çdo pjesë të ligjëratës përkatëse studentët aktivizohen me komente, pyetje dhe sqarime plotësuese si rezultat të pyetjeve. Studentët kanë komoditet që të komentojnë, pyesin dhe të sqarojnë dilemat dhe paqartësitë eventuale. |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:<br>• **TESTI –I 40% e pikëve**<br>• **TESTI –II 40%**<br>• **Aktiviteti (L) 10%**<br>• **Aktiviteti (U) 10%**<br>Testi-I realizohet me dy orë provim me shkrim, pasi që të realizohet 50% të programit mësimor të lëndës dhe Testi i dytë pasi të realizohet i tërë materiali. Provimi përfundimtar realizohet me gojë ose me shkrim në grupe të përshtatshme për kushte objektive të realizimit të provimit.Nëse provimi mbahet me shkrim rezultatet studentëve ju kumtohen më së voni në afat prej 7 ditësh nga dita e provimit përfundimtar. Studentët e pakënaqur me rezultatin kanë të drejtë ankese. |
| | |
| **Literatura primare:** | 1. Ligjërata të autorizuara, 2026<br>2. Vasilika Kume “Manaxhimi Strategjik”, 2010 |
| **Literatura shtesë:** | 1. Grup autorësh “Menaxhmenti Strategjik” Zagreb, 2008,<br>2. Izet Zeqiri “Menaxhmenti Strategjik” Shkup, 2011<br>3. Williason, Jenkins, Cooke, Moreton “Strategic Management and Business analysis” 2006 |

| Hartimi i planit mësimor | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Titulli i ligjëratës** | **Ushtrimet** |
| ***Java 1:*** | Hyrje në lëndë (objektivat, përmbajtja, metodat e punës, literatura | |
| ***Java 2:*** | Menaxhimi strategjik (një këndvështrim i përgjithshëm) | |
| ***Java 3***: | Krijimi i vizionit, i filozofisë dhe misionit të kompanisës | |
| ***Java 4:*** | Qëllimet e organizatës, Stakeholders të organizatës, Etika në biznes | |
| ***Java 5:*** | Studimi dhe parashikimii mjedisit, analiza konkurruese | |
| ***Java 6***: | Identifikimi i forcave konkurruese përmes analizës strukturore | |
| ***Java 7:*** | Analiza e mjedisit të brendshëm | |
| | TESTI-I | |
| ***Java 8:*** | Formulimi i objektivave dhe identifikimi i alternativave strategjike | |
| ***Java 9:*** | Identifikimi i alternativave strategjike (Strategjitë në nivel korporate) | |
| ***Java 10:*** | Zgjedhja dhe vlerësimi i alternativave strategjike | |
| ***Java 11***: | Matrica me 9 kutiza (GE) | |
| ***Java 12***: | Zbatimi i strategjisë | |
| ***Java 13***: | Kontrolli i strategjisë | |
| ***Java 14***: | Revizionet strategjike | |
| ***Java 15***: | Menaxhimi i ndryshimeve | |
| | TESTI-II | |

| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes |
|---|
| *Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.*<br>*Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.*<br>*Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.*<br>*Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.* |

**Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.**